



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/85

Datë: 02.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, dhe duke u bazuar në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit të Lartë 2005 - 2015, në kuadër të përkushtimit për të përmirësuar bazën materiale të personelit akademik dhe me synim për të ofruar një arsimim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Republika e Kosovës është shtet, shoqëri dhe ekonomi e dijes.
2. Arsimi i Lartë në Republikën e Kosovës ndërtohet dhe reformohet në parimin gjithëpërfshirës, të cilësisë dhe të diversitetit.
3. Arsimi i Lartë në Republikën e Kosovës të jetë i krahasueshëm, i matshëm dhe konkurrues në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.
4. Përmirësimi i bazës materiale i personelit akademik të Universitetit të Prishtinës duhet të sigurojë një arsim të cilësisë së lartë dhe kërkim shkencor në funksion të zhvillimit të vendit.
5. Paga bazë neto e profesorit ordinar është 1.000 (njëmijë) euro dhe ajo e asistentit të ri është 500 (pesëqind) euro nga buxheti i Kosovës.
6. Paga bazë neto e kategorive tjera të personelit akademik nga buxheti i Kosovës si: profesor i asocuar, profesor-asistent, profesor i shkollës së lartë, ligjërues, lektor, asistent, llogariten brenda kornizës 500 - 1000 (pesëqind - njëmijë) euro.
7. Personelit jo akademik i rritet paga 30 % nga buxheti i Kosovës.

8. Nga 1 tetori 2009 deri më 1 janar 2010, mjetet financiare do të sigurohen nga rezervat e Qeverisë dhe alokohen në programin e organizatës buxhetore "Universiteti" në kategorinë e pagave, ndërsa për vitet në vijim këto mjete do të sigurohen përmes procesit të rregullt me rastin e planifikimeve buxhetore.
9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe Universiteti i Prishtinës për zbatimin e këtij vendimi.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/85
Datë: 02.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe duke u bazuar në rekomandimet e Këshillit Kombëtar të Cilësisë të Agjencisë Kosovare për Akreditim, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Akreditohet dhe Licençohet si "Kolegj", BPrAL "Dardania" me këto programe studimi: Administrim Biznesi (BA), Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA), Administratë Publike (BA), Juridik i Përgjithshëm (BA) - me kusht të shkrirjes me programin e Kriminalistikës.
2. Kolegji "Dardania" mund të regjistrojë deri në 700 studentë të rinj në vitin akademik 2009/2010.
3. Kolegji "Dardania" mund të regjistrojë deri në 50 studentë të rinj në programet master.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të lëshojë licencë në përputhje me këtë vendim.
5. Akreditimi dhe Licenca kanë fuqi ligjore vetëm për vitin akademik 2009/2010.

6. Obligohet Agjencia Kosovare për Akreditim dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që në rast të moszbatimit të kushteve të akreditimit dhe licencës nga ana e BPrAL, ta tërheqin akreditimin dhe licencën e dhënë.
7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencia Kosovare për Akreditim që të monitorojnë përmbushjen e rekomandimeve në rastet e akreditimit me kusht.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/85

Datë: 02.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 tetor 2009, mori

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 01/73, të datës 07.07.2009

1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr. 01/73, i datës 07.07.2009

2. Zëvendësohet në tërësi pika 19. e vendimit Nr. 01/73, si vijon:

"Çdo BPrAL i cili bartë emrin "Kolegj" mund të regjistrojë deri në 700 studentë të rinj në vitin akademik 2009/2010, dhe çdo BPrAL që bartë emrin "Institut" mund të regjistrojë deri në 350 studentë të rinj në vitin akademik 2009/2010".

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë